VENDIM
Nr. 89, datë 6.2.2026

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 423, DATË 26.6.2024, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E VLERAVE PËR SECILIN ELEMENT PËRBËRËS TË PAGËS BRUTO MUJORE, TË KOMPENSIMEVE TË TJERA FINANCIARE, QË PËRFITOJNË PUNONJËSIT E POLICISË SË BURGJEVE GJATË QËNDRIMIT NË PUNË, DHE PROCEDURAVE TË PËRFITIMIT TË KËTYRE KOMPENSIMEVE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave "a" dhe "b", të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr.35/2023, "Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi", të ndryshuar, dhe të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr. 80/2020, "Për Policinë e Burgjeve", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Lidhja nr. 1 e vendimit nr. 423, datë 26.6.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore, të kompensimeve të tjera financiare, që përfitojnë punonjësit e Policisë së Burgjeve gjatë qëndrimit në punë, dhe procedurave të përfitimit të këtyre kompensimeve", zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Vlerat e elementit "paga për gradë", në lidhjen nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, janë rezultat i indeksimit në masën 2.5% dhe i politikës së rritjes së pagave për punonjësit me gradën "Inspektor" dhe "Kryeinspektor" dhe rezultat i indeksimit në masën 2.5% për gradat e tjera.
3. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2026, përballohen nga buxheti i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, i miratuar në ligjin nr. 87/2025, "Për buxhetin e vitit 2026".
4. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 janar 2026.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lidhja nr. 1

Paga për gradë për punonjësit e policisë së burgjeve

Roli	Grada	Paga për gradë
1	2	3
Bazë	Inspektor	73,500
	Kryeinspektor	88,000
I mesëm	Nënkomisar	97,375
	Komisar	107,650
	Kryekomisar (shef i sigurisë)	123,000
I lartë	Drejtues	153,750
	Drejtues i lartë (drejtor i Policisë)	174,250